

## MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E MIRËQËNIES SOCIALE DHE RINISË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, për projektin “Modernizimi i asistencës sociale”, me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën nga fillimi i projektit deri 28.02.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 46 datë 30.04.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 160/7 datë 05.05.2014, dërguar Z. Erjon Veliaj, Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### A. MASA ORGANIZATIVE

#### **I. Për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë:**

1. Në referim dhe mirëkuptim të kërkesës së Bankës Botërore për të bashkëpunuar me KLSH, për të kryer auditimin e pavarur të Projektit SAMP në tërësi dhe për auditimin financiar të transaksioneve që janë disbursuar dhe do të disbursohen nga huaja për pjesën e parë të projektit, rekomandojmë që:

*Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore, dhe me Ministrinë e Financave, të mundësojnë sa më shpejt kryerjen e auditimit të përvitshëm financiar të transaksioneve të pagesave të Ndhmës Ekonomike nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me Termat e Referencës të pranuar nga BB dhe me Standardet Ndërkombëtare të SAI-ve.*

Menjëherë

#### **II. Për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Njësinë e Zbatimit të Projektit:**

1. Duke qenë se nga auditimi i fondeve të akorduara nga Banka Botërore për projektin konstatohet se:

- niveli i disbursimeve ka qenë me ritme të ulëta, ç’ka reflektohet në faktin se nga fondet e akorduara nga huaja në shumën prej 38 milionë Euro, janë disbursuar vetëm 1,140,700 Euro, ose 3 % e shumës së huasë për dy pjesët e projektit;
- gjatë vitit të parë të zbatimit të Projektit, nga 17 indikatorë gjithsej për pjesën e parë të projektit “Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale”, është realizuar vetëm indikator i parë, në shumën 1,045,000 euro ose në masën 2.75% të shumës së huasë, ndërsa pjesa e dytë e projektit është realizuar në shumën 95,700 Euro ose në masën 0.25% të huasë, rekomandojmë:

*Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, të bashkëpunojnë dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar realizimin në kohë dhe sipas parashikimeve në Dokumentin Vlerësues të Projektit (PAD) të veprimtarive dhe arritjen e indikatorëve vijues të përcaktuar në pjesën e parë të projektit, me qëllim rritjen e nivelit të disbursimeve nga Huaja për përmbushjen e objektivave të projektit.*

## Menjëherë dhe në vijimësi

2. Duke qenë se një nga kushtet që duhet të plotësohej për bërjen efektive të Huasë, e cila ishte që përfituesi/MPÇSSHB të përgatiste një Manual Operacional të Projektit (MOP), nga auditimi rezultoi se MOP është hartuar nga Ministria me *6 muaj më vonë se afatet e parashikuara në Marrëveshjen e Huasë* dhe është miratuar nga të dy palët në qershor të vitit 2012, duke ju bërë edhe ndryshime e rishikime deri në maj 2013. Si pasojë:
  - Mospërgatitja dhe mosaprovimi në kohë nga ana e MPÇSSHB, ka sjellë vonesa në organizimin institucional për zbatimin e projektit;
  - mosmarrjen e masave për qarkullimin e fondeve të projektit, përfshirë protokollin dhe udhëzimet për menaxhimin financiar të projektit;
  - mospërgatitjen e aplikimeve të tërheqjes së fondeve, mbajtjen e të dhënave, auditimin, raportimin dhe kontrollin e brendshme;
  - mospërgatitjen e udhëzimeve për planifikimin dhe ekzekutimin e aktiviteteve të prokurimeve sipas pjesës 2 të projektit;
  - në protokollin për paraqitjen e evidencave të dokumentuara në përputhje me arritjen e DLI-ve; si dhe në politikat dhe procedurat për monitorimin e aktiviteteve të projektit, duke rënë ndesh me plotësimin e kërkesave të raportimit të tyre sipas nenit 5.01 (a) të kësaj marrëveshjeje.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se nga MPÇSSHB është ngritur me *një vit vonë*, nga ratifikimi në Parlament i Marrëveshjes së Huasë, grupi i punës përgjegjës për drejtimin e zbatimit të reformave në programet e ndihmës sociale dhe sigurimit të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projektit. Ky veprim bie ndesh me pikën 1, të germës A, të seksionit I të Marrëveshjes së Huasë.

***Për këtë rekomandojmë: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, të bashkëpunojë për respektimin e afateve dhe detyrimeve të përcaktuara në Manualin Operacional të Projektit dhe në Planet e Veprimit në përputhje me Marrëveshjen e Huasë për financimin e projektit "Modernizimi i asistencës Sociale", të miratuar me ligjin nr. 84/2012, datë 18.09.2012.***

## Deri në mbyllje të Projektit

3. Bazuar në marrëveshjen e financimit, u konstatua se, Huamarrësi, nëpërmjet MPÇSSHB-së, si monitoruese dhe vlerësuese e progresit të projektit, duhet të përgatiste raportet e projektit (në shqip dhe anglisht) në përputhje me dispozitat e paragrafit 5.08, të kushteve të përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën, duke ditur që edhe çdo raport i projektit mbulon periudhën e një semestri kalendarik, dhe i dorëzohet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

Nga auditimi u konstatua se, Njësia e Zbatimit të Projektit ka përgatitur dhe dërguar katër raporte progresive 3-mujore për zbatimin e projektit SAMP, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, përkatësisht zv/Ministrin, Sekretarin të Përgjithshëm në Ministri, Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Koordinatorës së Projektit në Ministri, vetëm në gjuhën angleze, ç'ka cenon transparencën dhe mungesë përshtatshmërie të informacionit për përdoruesit, ndaj këto Raporte duhet të përgatiten në dy gjuhë, atë angleze dhe shqipe. ***Për këtë rekomandojmë:***

*Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrë masa për të hartuar dhe dorëzuar raportet e ecurisë së projektit në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), në Bankën Botërore dhe në Ministrinë e Financave, brenda afateve të parashikuara në Marrëveshjen e huasë për financimin e projektit “Modernizimi i asistencës Sociale”, të miratuar me ligjin nr. 84/2012, datë 18.09.2012.*

*Vazhdimisht*

4. Nga auditimi i fondeve të akorduara nga kredia e IBRD, u konstatua se, fondet e financuara nga donatori nuk janë audituar nga auditues të pavarur të pranueshëm për Bankën, **për këtë rekomandojmë:**

*Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrin masa, për të kryer auditimin e pasqyrave financiare që lidhen me projektin, për çdo vit kalendarik duke filluar nga viti i parë i zbatimit të tij, dhe këto raporte të dorëzohen Bankës jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të kësaj periudhe, në përputhje me Marrëveshjen e huasë për financimin e projektit “Modernizimi i asistencës Sociale”, të miratuar me ligjin nr. 84/2012, datë 18.09.2012, Programi 2, Seksioni II, pika B. 3.*

*Menjëherë*

### **III. Për Njësinë e Zbatimit të Projektit:**

1. *Njësia e Zbatimit të Projektit, të marri masa për të zbatuar me përpikëri, në kohë dhe në cilësi të gjitha angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshja e huasë për financimin e projektit “Modernizimi i asistencës Sociale”, të miratuar me ligjin nr. 84/2012, datë 18.09.2012, në lidhje me mënyrën e raportimit të donatorët, ritmet e disbursimeve, për të realizuar objektivat dhe komponentët e projektit.*

*Deri në mbyllje të projektit*

2. Nën Komponentin e dytë të Projektit janë blerë mallra për nevojat e Njesisë së Zbatimit të Projektit në shumën 9059 Euro. Nga auditimi u konstatua se për këto mallra, nuk janë zbatuar procedurat për hyrje-dalje në magazine dhe mungojnë procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallit nga përfaqësues të projektit. Ky veprim ky bie ndesh me nenin 6 “Evidenca mbështetëse”, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me nenin 4/26 “Dokument financiar”, të ligjit 10296, datë 8.07.2011, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe me pikën 35/b, 37, 38 dhe 39, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. **Për këtë rekomandojmë:**

*Njësia e Zbatimit të Projektit, të ngrejë një komision për marrjen në dorëzim të mallrave të blerë për nevoja të projektit, të përgatisë dhe të administrojë dokumentacionin përkatës justifikues për çdo veprim lidhur me blerjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave sipas parashikimeve dhe në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ligjin 10296, datë 8.07.2011, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Menaxhimi financiar dhe kontrolli”.*

*Menjëherë*

### **B. MASA DISIPLINORE**

**I** - Referuar parregullsive dhe shkeljeve të evidentuara nga grupi i auditimit gjatë auditimit të projektit, “Modernizimi i asistencës Sociale”, u konstatua se:

- nga ana e MPÇSSHB është ngritur me **një vit vonesë**, nga ratifikimi në Parlament i Marrëveshjes së Huasë, grupi i punës, përgjegjës për drejtimin e zbatimit të reformave në programet e ndihmës sociale dhe sigurimit të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projektit. Ky veprim bie ndesh me pikën 1, të germës A, të seksionit I të Marrëveshjes së Huasë;
- është përgatitur **me 6 muaj vonesë** Manuali Operacional i Projektit (MOP), nga Ministria dhe është miratuar në Qershor 2012, duke sjellë si pasojë:
  1. vonesa në organizimin institucional për zbatimin e projektit;
  2. mosmarrjen e masave për qarkullimin e fondeve të projektit, përfshirë protokollin dhe udhëzimet për menaxhimin financiar të projektit;
  3. mospërgatitjen e aplikimeve të tërheqjes së fondeve, mbajtjen e të dhënave, auditimin, raportimin dhe kontrollin e brendshme;
  4. mospërgatitjen e udhëzimeve për planifikimin dhe ekzekutimin e aktiviteteve të prokurimeve sipas pjesës 2 të projektit;
  5. në protokollin për paraqitjen e evidencave të dokumentuara në përputhje me arritjen e DLI-ve; si dhe në politikën dhe procedurat për monitorimin e aktiviteteve të projektit, duke rënë ndesh me plotësimin e kërkesave të raportimit të tyre sipas nenit 5.01 (a) të kësaj marrëveshjeje.

Për këto, bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar, mban përgjegjësi ish-ministri [REDAKTUAR] Pavarësisht se shkeljet e sipërpërmenduar qëndrojnë, për ish ministrin [REDAKTUAR] nuk rekomandohet masë disiplinore pasi ajo nuk mund të ezaurohen si e tillë, pasi personi i sipërpërmendur nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e saj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Me kërkesë të Bankës Botërore do të ushtrohet auditim në vijimësi për këtë projekt, në përputhje me termat e referencës të përgatitura dhe të paraqitura nga BB në bashkëpunim dhe me institucionet që janë të përfshira, si MMSR dhe Ministria e Financave, për të realizuar auditim të përvitshëm financiar të transaksioneve të pagesave të Ndihmës Ekonomike, sipas kuadrit të raportimit financiar dhe legjislacionit në Shqipëri dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të SAI-ve.

*Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Yllka Pulashi, Luljeta Shtylla, Ina Sokoli më tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**